



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC

945/3
Nr. ___prot.

Roskovec, më 03.04.2023

SHPALLJE
(Për Vende Të Lira Pune)

Pozicioni: Asistent Projektit

Vendndodhja: Roskovec / SHQIPËRI

Me kohë të plotë / të pjesshme: Me kohë të plotë (17 muaj)

Kohëzgjatja: 17 muaj

Afati i fundit për aplikim: 07.04.2023, 16:00 CET

Projekti: Rivitalizimi i Shkolles Qender Komunitare Kurjan" per akses me te mire ne Zhvillimin Ekonomik dhe Social te te rinjeve dhe Grupeve te Disavantazuara" synon të punësojë "Asistent projektit", për zbatimin e projektit.

Asistenti i Projektit: do t'i raportojë drejtpërdrejt Përfaqësuesit Ligjor të bashkise Roskovec dhe Menaxherit te projektit, per ecurin e projektit.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Lehtësimi i menaxhimit të përditshëm të projektit;
- Përgatitja e dokumenteve të punës dhe materialeve bazë që kanë të bëjnë me çështjet e trajtuara përmes aktiviteteve të projektit;
- Asiston Koordinatorin e projektit në zbatimin e përgjithshëm të projektit;
- Ndihmon në përgatitjen e axhendës dhe materialeve te nevojshme për takime, përfshirë komunikimin me pjesëmarrësit;
- Mban shënime të sakta dhe në kohë për të gjitha aktivitetet, te cilat arkivohen në mënyrë sistematike;
- Te ndjeki afatet e kontratave/projekteve dhe te eskaloje problematikat tek personat pergjegjes;
- Asiston menaxherin e projektit në monitorimin e progresit e përgjithshëm të projektit;
- Ndihmone ne perpilimin e materialeve permbajtesore te projektit, perfshire konceptet e ngjarjeve si tryezat e rumbullaketa, materialet informuese;
- Ndihmon në komunikimin, përditësimin dhe mbledhjen e informacionit mbi temat përkatëse të projektit;
- Kryen detyra të tjera sipas nevojës.
- Koordinim me stafin e projektit të Bashkisë Roskovec për zbatimin e projektit.

- Dërgon në kohë të gjithë informacionin e kërkuar tek Aplikuesi Kryesor.

Kualifikimet dhe aftësitë:

Arsimi i mesëm i përgjithshëm ose i lartë Aftësi shumë të mira komunikimi me shkrim dhe me gojë, në gjuhën angleze Qëndrim konstruktiv, energjik dhe pozitiv në punë. Aftësi të mira menaxhuese dhe koordinuese dhe ndjenjë e lartë përgjegjësie.

Përvojë e Përgjithshme e Punës :

1. Minimumi 1 vit përvojë pune të përgjithshme.
2. Përvoja e mëparshme relevante e punës me projekte të financuara nga BE ose donatorë të tjerë do të jetë një avantazh. Ky pozicion ofron një pakete terheqëse shperblimi duke përfshirë një page neto konkurruese.

Procedura e aplikimit:

Aplikantët duhet të dorëzojnë një leter motivuese dhe një CV në gjuhën angleze/shqip. Mund të përfshihet çdo dokument shtesë përkatës. Aplikimet duhet të dorëzohen jo më vonë se data 07.04.2023, në adresën e email:enirjetashehu@gmail.com ose pranë Zyrës së protokollit, bashkia Roskovec.

Në subjektin e e-mail-it/kërkesës duhet të shkruhet: Aplikim për "**Asistent Projekti**", projekti, **Rivitalizimi i Shkollës Qender Komunitare Kurjan**" Për akses më të mirë në Zhvillimin Ekonomik dhe Social të rinjeve dhe Grupeve të Disavantazuara".

KRYETAR
Majlinda Bufi

